



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic

Prosecution

Autoriteti Kompetent / Kryeprokurori

AD.nr.14/2024

Datë: 01.10.2024

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me ankesën e pranuar përmes postës elektronike nga pala H.B-P., e të cilën sipas detyrës zyrtare është duke e trajtuar nga aspekti disiplinor, kundër P.P., Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 01.10.2024 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore kundër P.P., Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, pasi që duke u bazuar në nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, veprimet e prokurorit nuk paraqesin shkelje disiplinore.

Arsyetim

Me datë 02.09.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, përmes postës elektronike ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e palës ankuese H.B-P., e cila ka cilësinë e palës së dëmtuar në lëndën penale PP/II.nr., kundër prokurorit P.P., i cili ka qenë në përfaqësim të kësaj lënde pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, me pretendimet se prokurori P.P. është përqendruar vetëm në ngjarjen e 27 Nëntorit 2020, duke mos marrë parasysh faktin se edhe pas kësaj date i pandehuri me dy vëllezërit e tij kanë vazhduar me sulme dhe kërcënime kundër tyre, mjeshtrëve dhe mysafirëve të tyre, e të cilat raste prapë janë raportuar në polici, ndërkaq prokurori P.P. e ka fokusuar mbrojtjen e të pandehurit vetëm në ngjarjen e dt.27.11.2020 si dhe e ka reduktuar numrin e kërcënuesve nga tre vëllezër në vetëm njërin prej tyre, pra në Sh.M., ndërkaq për më tepër ai e ka shpallur të pandehurin plotësisht të pafajshëm në seancën e dt.26.07.2024. Ndër të tjera, pala ankuese pretendon se prokurori P.P. ka qenë i njëanshëm, duke mos i parashtruar pyetje të

pandehurit se pse është dashur të shkoj të kërcënoj të dëmtuarën në mënyrë të sinkronizuar me vëllezërit, në shtëpinë e saj, e nga këto pretendime të palës ankuese, ne si Autoritet Kompetent kemi hapur procedurë disiplinore kundër prokurorit P.P. në mënyrë që të hetojmë pretendimet ankimore, nëse veprimet e prokurorit në fjalë kanë rënë ndesh me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj Prokurorit P.P.

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

- Me datë 26.09.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore me numër AD.nr.14/2024.
- Me datë 27.09.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimin dhe regjistrimin e ankesës.

Të gjeturat e Autoritetit Kompetent:

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 04.02.2021 ka pranuar kallëzimin penal nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor Jugu në Prishtinë, me numër të rastit ..., të datës 04.02.2021, kundër të dyshuarit Sh.M., me dyshimin se i njëjti ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 182 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK-së). Me datë 09.02.2021, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur Aktakuzë kundër të pandehurit Sh.M., në drejtim të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së. Me datë 28.02.2024, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm është mbajtur shqyrtimi fillestar, në të cilën seancë i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë. Me datë 11.07.2024, dt.04.06.2024 dhe dt.26.07.2024 janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor, në të cilat kanë prezantuar palët si dhe prokurori P.P., në të cilat seanca janë administruar provat ndërkaq në seancën e dt.26.07.2024, në fjalën përfundimtare, prokurori P.P. në mungesë të provave të cilat e mbështesin aktakuzën është tërheqë nga ndjekja penale ndaj të pandehurit Sh.M., ndërkaq Gjykata Themelore në Prishtinë, me datë 26.08.2024 në kuptim të nenit 362 par.1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje KPPRK-së), ka marrë Aktgjykim refuzues.

Duke analizuar rastin, po ashtu rrjedhën e veprimeve të ndërmarra nga Prokurori P.P., Autoriteti Kompetent vlerëson se veprimet e tij nuk përbëjnë shkelje disiplinore të cilat janë të parapara në mënyrë shprehimore me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit _____

- Marrja e raportit me shkrim nga ana e prokurorit P.P. lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP/II.nr...

Deklarimet e palës ankuese

Me datë 02.09.2024, pala ankuese H.B-P., përmes postës elektronike ka dërguar ankesë kundër prokurorit P.P., e të cilën ankesë ne si Autoritet Kompetent jemi duke e trajtuar nga aspekti

disiplinor. Përmes ankesës së saj, pala H.B-P. pretendon se prokurori P.P., i cili ka qenë në përfaqësim të lëndës penale PP/II.nr.. pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, është përqendruar vetëm në ngjarjen e 27 Nëntorit 2020, duke mos marrë parasysh faktin se edhe pas kësaj date i pandehuri me dy vëllezërit e tij kanë vazhduar me sulme dhe kërcënime kundër tyre, mjeshtërive dhe mysafirëve të tyre, e të cilat raste prapë janë raportuar në polici, ndërkaq prokurori P.P. e ka fokusuar mbrojtjen e të pandehurit vetëm në ngjarjen e dt.27.11.2020 si dhe e ka reduktuar numrin e kërcënuesve nga tre vëllezër në vetëm njërin prej tyre, pra në Sh.M., ndërkaq për më tepër ai e ka shpallur të pandehurin plotësisht të pafajshëm në seancën e dt.26.07.2024. Ndër të tjera, pala ankuese pretendon se prokurori P.P. ka qenë i njëanshëm, duke mos i parashtruar pyetje të pandehurit se pse është dashur të shkosh të kërcënosh të dëmtuarën në mënyrë të sinkronizuar me vëllezërit e tij, në shtëpinë e saj. Pas pranimit të ankesës, ne si Autoritet Kompetent kemi hapur procedurë disiplinore kundër prokurorit P.P. në mënyrë që të hetojmë pretendimet nëse veprimet tij kanë rënë ndesh me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Deklarimet e Prokurorit P.P. në raportin e tij të dt.27.09.2024

Prokurori P.P. në raportin e tij të dërguar përmes postës elektronike me datë 27.09.2024, ndër të tjera ka deklaruar se: *Lidhur me ankesën e cila tashmë ka marrë numrin AD.nr.14/2024, e ripërsërisë se:*

-qëndroj pranë vendimit për t'u tërhequr nga ndjekja penale në lëndën PP.II.nr... në të cilën lëndë nuk ka pasur asnjë provë të besueshme e cila e bën të besueshëm ekzistimin e veprës penale Ngacmimi, siç ka pretenduar pala e dëmtuar H.B.

-Në këtë çështje penale ekziston vetëm deklarimi i të dëmtuarës dhe deklarimi i të pandehurit i cili në tërësi e mohon e kryerjen e veprës penale.

-Lidhur me pretendimin e të dëmtuarës se i pandehuri, ditën kritike e ka kanosur në prezencën e zyrtarëve policor, po e theksojmë se në raportin e oficerit askund nuk theksohet se i pandehuri e ka kanosur të dëmtuarën;

-Gjatë marrjes në pyetje të të dëmtuarës, e cila është pyetur lidhur me veprën penale të Ngacmimit, e njëjta në asnjë moment nuk ka përsëritur asnjë element thelbësor të veprës Ngacmimi (si mesazhe, përcjellje, apo të ngjashme) por është fokusuar në çështje pronësore, rreth shfrytëzimit të rrugës publike ku e dëmtuara pretendon se i pandehuri kishte vendosur pengesa në rrugë, e që sipas raportit të oficerit rezulton se i pandehuri i kishte larguar pengesat pas arritjes së patrullës së policisë.

-Në këtë çështje penale gjatë shqyrtimit gjyqësor e dëmtuara e ka propozuar si dëshmitar edhe bashkëshortin e saj duke thënë se ka qenë në vendin e ngjarjes, por që sipas shkresave të lëndës askund nuk ka rezultuar se edhe bashkëshorti i të dëmtuarës ka qenë i pranishëm dhe as që ka dhënë deklaratë në polici në ditën kritike. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, i pyetur se pse nuk kishte dhënë deklaratë në Polici në ditën kritike, bashkëshorti i të dëmtuarës është përgjigjur se këtë çështje ia kishte lënë bashkëshortes së tij.

-Për më tepër edhe pse dëshmia e të dëmtuarës ka qenë e përqendruar në mosmarrëveshje pronësore me të pandehurin, e dëmtuara as në këtë aspekt nuk ka ofruar prova se kishte nisur padi civile apo administrative ndaj të pandehurit.

Për arsyet e cekura kam vepruar sipas nenit 3 par. 2 të KPPRK si dhe në bazë nenit 257 par.1 të KPPRK.

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se veprimet e prokurorit P.P. gjatë përfaqësimit të lëndës penale PP/II.nr... pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, kanë qenë në kuadër të autorizimeve të tij ligjore dhe kushtetuese. Kodi nr. 08/1-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (tutje KPPRK), neni 21, ka paraparë se ***“Prokurori i shtetit mund të tërhiqet nga ndjekja deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor para gjykatës themelore, kurse në procedurat para gjykatës më të lartë, ai mund të tërhiqet nga ndjekja vetëm në rastet e parapara me këtë Kod”***. Në nenin 257 par.1 të KPPRK-së përcaktohet se ***“Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”***. Nga shqyrtimi i kallëzimit penal kemi gjetur se e vetmja provë inkriminuese është deklarata e të dëmtuarës H.B-P., e cila ka deklaruar se kanë dhunë psikologjike nga i pandehuri Sh.M. dhe për herë të parë kanë lajmëruar policinë me datë 27.11.2020, ku i pandehuri kishte vendosur pengesa në rrugën publike, e të cilat e dëmtuara i kishte thënë që ti hiqte, por që i pandehuri i kishte thënë se nuk guxon askush me heqë pengesën nga rruga publike, për çka e dëmtuara është detyruar ta lajmëroj policinë, pasi që ajo dhe familja e saj janë ndier të kërcënuar.

Në këtë drejtim, deklarimi i të dëmtuarës ishte e vetmja provë që e ngarkonte të akuzuarin deri diku për kryerjen e kësaj vepre penale dhe jo në mënyrë të plotë në përmbushje të elementeve të figurës së veprës penale nga neni 182 par.1 të KPRK-së. Ligjvënësi, në nenin 182 par.1 të KPRK-së ka përcaktuar elementet e figurës së veprës penale Ngacmimi, ashtu që ***“Kushdo që përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”***. Figura e veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së parasheh elemente që kanë të bëjnë me ***“Vëmendje apo komunikim”***, e të cilat përfshijnë përcjelljen apo qëndrimin në pritje; shfaqjen e vazhdueshme të shtëpia, shkolla, puna apo qendra rekreative; përsëritjen e thirrjeve telefonike; dërgimin apo lënien e porosive; dërgimin e mesazheve telefonike, letrave postare apo postës elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera”. Në këtë drejtim, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës gjejmë se me asnjë provë të bindshme nuk është mbështetur aktakuza PP/II.nr..., e datës 09.02.2021, e cila aktakuzë mbështetjen e saj të vetme e ka vetëm në deklaratimet e të dëmtuarës H.B-P., e që në rrethana të tilla vjen në shprehje edhe parimi In Dubio Pro Reo, i cili përcakton se ***“Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”***, e në ndërlidhje me këtë, po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “in peius” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të

arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë, kurse për argumentet që janë “in favorem” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Prokurori P.P. i cili ka qenë në përfaqësim të kësaj lënde penale, me rastin e tërheqjen nga aktakuza ka vepruar edhe në pajtim me nenin 257 par.1 të KPPRK-së, në të cilën parashihet që ***“Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”***. Andaj nga provat me relevancë juridike për këtë çështje penale, prova e vetme dhe kryesore ka qenë deklarata e të dëmtuarës, e cila përveç faktit që nuk tregon inkriminim penal, po ashtu nuk krijon bazën legale për të mbetur pranë një aktakuze të pambështetur në prova.

Dëshmia e të dëmtuarës H.B-P. si në deklaratën e dhënë në polici me datë 04.01.2021 po ashtu edhe në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 26.07.2024 ka qenë e përqendruar vetëm në çështje të vendosjes së pengesave dhe bllokimit të rrugës nga ana e të pandehurit, ndërkaq deklarimet sa i përket shqetësimeve të vazhdueshme dhe kërcënimeve të cilat ajo pretendon se i ka pasur nga i pandehuri, nuk kanë pasur mbështetje në ndonjë provë tjetër qoftë personale apo materiale në këtë çështje penale. E dëmtuara deklaron se edhe bashkëshorti i saj A.P. ditën kritike ka qenë prezent në momentin kur është kërcënuar nga i pandehuri, mirëpo nga i njëjti nuk është marrë deklaratë në polici, e që në këtë drejtim është kontestuese fakti nëse bashkëshorti i të dëmtuarës ka qenë prezent ditën kritike apo jo, ndërkaq në deklarimin e tij në gjykatë A.P. në pyetjen e Prokurorit se pse nuk kishte dhënë deklaratë në polici nëse ka qenë prezent ditën kritike, i njëjti ishte përgjigjur se nuk ka dhënë deklaratë sepse ia ka lënë bashkëshortes që të merret me këtë çështje. Përveç tjerash, e dëmtuara H.B-P. deklaron se është kanosur në prezencë të zyrtarëve policor, mirëpo nga shkresat e lëndës, respektivisht raporti policor i dt.04.01.2021, nuk theksohet askund se e dëmtuara ishte kanosur nga i pandehuri ditën kritike.

E dëmtuara në ankesën e saj pretendon se prokurori P.P. e ka reduktuar numrin e kërcënuesve nga tre vëllezër në vetëm njërin prej tyre, e të cilat pretendime të palës nuk qëndrojnë për faktin se Aktakuza PP/II.nr... e dt.09.02.2021 është ngritur nga një prokuror tjetër, i cili pasi që është pensionuar, lënda në fjalë për përfaqësim pranë gjykatës i është kaluar prokurori P.P., andaj prokurori P.P. ka qenë i obliguar në përfaqësimin e aktakuzës të ngritur nga një prokuror tjetër dhe rrjedhimisht do ishte e pamundur realizimi i asaj çka pala ankuese pretendon, sepse kallëzimi penal nga policia ka ardhur kundër të pandehurit Sh.M., e që edhe aktakuza është ngritur vetëm kundër të njëjtit, mirëpo aktakuzën nuk e ka ngritur prokurori P.P., por që prokurori në fjalë ka qenë vetëm në përfaqësim të lëndës në gjykatë.

Pala ankuese ndër të tjera pretendon se prokurori P.P. ka qenë i njëanshëm si dhe nuk i ka parashtruar pyetjet e duhura të akuzuarit Sh.M, ne si Autoritet Kompetent në asnjë rrethanë nuk kemi gjetur njëanshmëri të shprehur nga ana e prokurorit P.P. gjatë përfaqësimit të kësaj lënde pranë gjykatës kompetente, ndërkaq sa i përket pyetjeve të parashtruara nga ana e prokurorit P.P. ndaj të akuzuarit Sh.M. konsiderojmë se është në diskrecionin e prokurorit të çështjes mbi pyetjet që duhen parashtruar palëve në procedurë e të cilat kanë relevancë për çështjen penale, e në këtë drejtim edhe i dëmtuari si palë në procedurë ka të drejtën e parashtrimit të pyetjeve ndaj të akuzuarit, andaj një të drejtë të tillë e ka pasur edhe pala ankuese H.B-P. gjatë shqyrtimit gjyqësor e të cilën ka mundur ta shfrytëzojë në parashtrimin e pyetjeve të cilat ajo si palë e dëmtuar i ka konsideruar si të rëndësishme për çështjen.

Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë obligon prokurorët që ndër të tjera të marrin parasysh edhe rrethanat që janë në favor të të pandehurit, në respektim të konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, gjithmonë në zbatim të standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare, e që në rastin konkret konsiderojmë se Prokurori P.P. në përfaqësimin e kësaj lënde penale pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë ka qenë në respektim të plotë të rregullativës ligjore vendore dhe asaj ndërkombëtare si dhe akteve të tjera nënligjore mbi të cilat funksionon Institucioni i Prokurorit të Shtetit.


Në kontekst të veprimeve të lartpërmendura, si Autoritet Kompetent, vlerësojmë se Prokurori P.P. nuk është përfshirë në veprime të cilat do të binin ndesh me dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga krejt çka u konstatuar më lartë, kemi gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet e deklaruara në këtë ankesë disiplinore, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar se veprimet e prokurorit paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ankesën disiplinore e REFUZOJMË SI TË PABAZUAR.

Me sa u cek më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

AUTORITETI KOMPETENT KRYEPROKURORI



Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Prokurorial të Kosovës
- Arkivës